

## KOMISIONI

## VENDIM I KOMISIONIT

Datë 30 Nëntor 1998

**Për sqarimin të Aneksit A të Rregullores së Këshillit (EC) Nr. 2223/96 lidhur me parimet mbi**

**matjen e çmimeve dhe volumeve në llogaritë kombëtare**

*(njoftuar sipas dokumentit zyrtar nr.C(1998) 3685)*

**(Teksti sipas rëndësisë së EEA)**

(98/715/KE)

## KOMISIONI I KOMUNITETIT EVROPIAN,

Referuar Traktatit për themelimin e Komunitetit Evropian,

Duke marrë në konsideratë Rregulloren e Këshillit (KE) Nr. 2223/96 datë 25 Qershor 1996 mbi Sistemin Evropian të Llogarive Kombëtare dhe Rajonale në Komunitet (1), ndryshuar nga Rregullorja (KE) Nr. 448/1996 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit (2), dhe në veçanti neni 2 (2) i tij;

- (1) Duke qenë se është e nevojshme të përmirësohet krahasueshmëria e të dhënave të produktit të brëndshëm bruto në terma real (PBB) midis Shteteve Anëtare në funksion të zbatimit të nenit 2 të Rregullores së Këshillit (KE) nr.1467/97, datë 7 Korrik 1997 për përshpejtimin dhe qartësimin e zbatimit të procedurave së defiçitit të tejkaluar dhe rezolutës së Këshillit Evropian për Paktin e Stabilitetit dhe Rritjes (Amsterdam, 17 qershor 1997) dhe për qëllime të mbikëqyrjes shumëpalshe në përgjithësi;
- (2) Duke qenë se zbatimi dhe mbikëqyrja e Bashkimit Ekonomik dhe Monetar kërkon informacion të krahasueshëm, të përditësuar dhe të besueshëm mbi strukturën dhe zhvillimet ekonomike të çdo Shteti Anëtar;
- (3) Duke qenë se Komisioni duhet të luajë rol në administrimin e bashkimit Ekonomik Monetar dhe në veçanti t'i raportojë Këshillit mbi situatën buxhetore dhe shumën e borxhit kombëtar të çdo Shteti Anëtar;
- (4) Ndërsa llogaritë ekonomike në terma realë, të përshtatura me ndryshimet e çmimeve, janë një mjet

themelor për analizën e situatës ekonomike dhe buxhetore të një vendi, me kusht që të jenë përpiluar në bazë të parimeve unike që nuk janë të hapura për interpretime të ndryshme; Ndërsa për këtë qëllim rekomandohet që llogaritja e të dhënave me çmimet e vitit të mëparshëm në kuadër të Rregullores (KE) Nr. 2223/96 të thellohet dhe forcohet;

- (5) Ndërsa Komisioni duhet të përdorë agregatët e llogarive kombëtare në terma realë për Komunitetin, qëllimet e politikave dhe, në veçanti, për mbikëqyrjen e paktit të stabilitetit dhe rritjes;
- (6) Ndërsa për të vlerësuar pasojat e recesionit ekonomik Shtetet Anëtare duhet të marrin përgjithësisht si referencë çdo reduktim vjetor të real GDP prej të paktën 0,75%; ndërsa tejkalimi i vlerave të referencës pas një recesioni të rëndë ekonomik është e jashtëzakonshme, vetëm nëse PBB-ja në terma realë regjistron një ulje vjetore prej të paktën 2 %;
- (7) Ndërsa rezultatet e llogarive në terma realë të të gjitha Shteteve Anëtare të përpiluara sipas dispozitave të paraqitura nga ky vendim duhet tu bëhen të disponueshme përdoruesve nga Komisioni në datat specifike, veçanërisht në lidhje me mbikëqyrjen e konvergencave ekonomike dhe monetare;
- (8) Ndërsa dispozitat e paraqitura me këtë vendim janë hapat e parë drejt rregullave të përbashkëta të përpilimit të llogarive kombëtare për Shtetet Anëtare në terma reale, për kërkesat e Komunitetit, duke mundësuar krahasimin dhe cilësinë e rezultateve ndërmjet Shteteve Anëtare;

(1) OJ L 310, 30. 11. 1996, p. 1.

(2) OJ L 58, 27. 2. 1998, p. 1.

(3) OJ L 209, 2. 8. 1997, p. 6.

(4) OJ L 236, 2. 8. 1997, p. 1.

- (9) Ndërsa rezultatet e llogarive në terma realë për kërkesat e Komunitetit duhet të jenë subjekt i trajtimit statistikor dhe komunikimit me Komisionin në datat e përcaktuara me Rregullore (KE) Nr 2223/96 dhe nga Rregullorja e Këshillit (KE) 3605/93 i datës 22 nëntor 1993 mbi zbatimin e Protokollit për procedurën e difiçitit të tejkaluar (1);
- (10) Megjithatë, duke pasur parasysh rëndësinë e llogarive dhe nivelin e detajimit, si dhe situatën në lidhje me statistikat në Shtetet Anëtare, afatet shtesë për zbatimin e këtyre dispozitave duhet t'u jepen përjashtimisht dhe përkohësisht Shteteve Anëtare të cilat, objektivisht, nuk do të jenë në gjendje të respektojnë rregullat e përcaktuara në këtë Vendim kur zbatohet Rregullorja (KE) Nr. 2223/96;
- (11) Ndërsa masat e parashikuara në këtë vendim janë në përputhje me mendimin e Komitetit të Programit Statistikor Evropian Komuniteti (KPS), i krijuar me Vendim të Këshillit 89/382/EEC, Euratom (2), dhe Komitetit për Statistikat Monetare, Financiare dhe të Bilancit të Pagesave (CMFB), i krijuar me Vendimin 91/115/KEE (3);

#### KA MIRATUAR KËTË VENDIM:

##### *Neni 1*

##### Objekti

Qëllimi i këtij vendimi është të qartësojë më tej parimet për matjen e çmimeve dhe volumeve të përfshira në kapitullin 10 të aneksit A të Rregullores (KE) Nr.2223/96 si nevojë e harmonizimit të tyre me rezultatet e programit. Sqarimet e dhëna në këtë vendim do të përdoren për transmetimin e të dhënave në Eurostat që nga transmetimi i parë i të dhënave në përputhje me Rregulloren (KE) Nr. 2223/96 e në vazhdim, të paktën për të dhënat që i referohen viteve 1995 e më vonë.

##### *Neni 2*

Sqarime për parimet e përgjithshme për matjen e çmimeve dhe volumit.

Sqarime për parimet e përgjithshme që do të ndiqen në matjen e çmimeve dhe volumeve të përfshira në Kapitullin 10 të Shtojcës A të Rregullores (KE) Nr. 2223/96, veçanërisht sa i përket nivelit të agregimit, zgjedhjes së formulës së indeksit dhe vitit bazë, të përcaktuara në Pjesën I të Aneksit I të këtij vendimi.

##### *Neni 3*

Klasifikimi i metodave sipas produktit  
Klasifikimi i metodave për lloje të caktuara të produkteve në metodat më të përshtatshme, janë alternativat që mund të përdoren nëse metodat më të përshtatshme nuk mund të zbatohen, dhe metodat që nuk do të përdoren si nga transmetimi I parë I të dhënave në Eurostat në përputhje me Rregulloren (KE) Nr. 2223/96 e tutje, është përcaktuar në Pjesët II dhe III të aneksit I të këtij vendimi.

##### *Neni 4*

##### Programi kërkimor

Për ato produkte për të cilat klasifikimi i metodave të përcaktuara në nenin 3 nuk është përmendur në aneksin I të këtij Vendimi, ky klasifikim do të përcaktohet duke marrë marrë parasysh rezultatet e një programi kërkimor, i cili do të përfundojë deri në fund të vitit 2000 dhe pas vendimit i KPS-së.

##### *Neni 5*

##### Periudhat kalimtare

Periudhat kalimtare për zbatimin e parimeve, siç sqarohet në nenin 2, janë përcaktuar, për çdo Shtet Anëtar, në Aneksin II të këtij Vendimi. Shtetet Anëtare mund të kërkojnë, përveç kësaj, për periudhat kalimtare që do të jepen për zbatimin e metoda e përmendur në nenin 3, i cili do të vendoset deri në fund të vitit 1998. Në rastin e një Shteti Anëtar për të cilin I jepet një periudhë kalimtare e cila paraqet për një vit të caktuar uljen e PBB-së në terma realë e llogaritur sipas metodat kombëtare të vendosura, shteti anëtar do të ndihmojë Eurostatin në masën më të plotë të mundshme në vlerësimin e efektit të çdo devijimi nga parimet e përfshira në këtë vendim.

##### *Neni 6*

##### Inventari

Shtetet Anëtare do të transmetojnë në Eurostat, të paktën deri në fund të vitit 2002, inventarin e plotë të Procedurave dhe statistikat bazë të përdorura për të matur PBB-në në terma realë dhe komponentët e tij. Inventari duhet të paktën të mbulojë metodat e përdorura në vlerësimet përfundimtare.

Neni 7

Adresat

Ky Vendim u drejtohet Shteteve Anëtare.

Mbajtur në Bruksel, 30 Nëntor 1998.

*Për Komisionin*  
Yves-Thibault DE SILGUY  
*Anëtar i Komisionit*

## ANEKS I

### PJESA I

#### PARIME TË PËRGJITHSHME TË MATJES SË ÇMIMEVE DHE VËLLIMIT

##### Hyrje

Vlerësimet me çmimet e vitit të mëparshëm janë të ndryshme nga vlerësimet me çmime korrente, në disa aspekte themelore. Më konkretisht, vlerësimet në çmime korrente janë agregim i transaksioneve të ndodhura brenda kuadrit të kontabilitetit. Llogaritë me çmimet e vitit të mëparshëm përshkruajnë situatën ekonomike në një vit të caktuar e vlerësuar me çmimet e vitit të mëparshëm. Në realitet transaksionet e vitit korrent nuk mund të jenë identike me transaksionet e vitit të mëparshëm si pasojë e çmimeve. Vlerat e transaksionit zërthehen në komponentët e çmimit dhe sasisë. Në parim, komponentët e çmimit duhet të përfshijnë ndryshimet që rrjedhin vetëm nga ndryshimet e çmimeve, ndërkohë që të gjitha ndryshimet e tjera duhet të përfshihen në komponentin e sasisë (ESA 95, pika 10.01). Megjithatë, për një pjesë të produkteve është e vështirë ndarja e ndryshimeve në: “ndryshim çnmimi” dhe “ndryshim në sasi” (ESA 95, pika 10.06). Prandaj, një grup rregullash për matjen e çmimeve dhe sasive duhet të zbatohen në mënyrë që rezultatet të përafrohen me pershtatjen teorike çmim/sasi, dhe duhet të jenë të zbatueshme në mënyrë të krahasueshme në të gjitha Shtetet Anëtare.

Në pjesën e I-rë përcaktohen parimet e përgjithshme të këtij kuadri, ndërsa në Pjesët II dhe III trajtohen më hollësisht procedurat e vlerësimit me metodën e prodhimit dhe të shpenzimeve.

Parimet e përcaktuara në këtë vendim zbatohen për të dhënat vjetore. Sigurisht, një parim udhëzues duhet të jenë dhe për llogaritë tremujore në përputhje me llogaritë vjetore, në mënyrë që llogaritë tremujore të përafrohen me rezultatet përfundimtare. Çështjet specifike që lidhen me llogaritë tremujore janë çmimet periudhës së mëparshme që do të diskutohen në manualin e ardhshëm për llogaritë tremujore.

Kapitulli 10 i ESA 95 shpreh qartësisht për metodën e integruar të llogarive në çmimet e vitit të mëparshëm (ESA 95, pika 10.04 dhe 10.08). PBB-ja e vlerësuar me metodën e prodhimit dhe shpenzimeve me çmimet e vitit të mëparshëm, balancohet në nivel produkti të detajuar duke përdorur tabelat burim – përdorime (TBP).

Në përdorimin e tabelave burim, përdorime duhet të ruhet konsistenca e indekseve të çmimeve. Gjithashtu, deflatorët si: Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) dhe Indeksi i Çmimeve të Prodhimit (IÇP) mund të krahasohen me njëri – tjetrin. Në një sistem të bazuar në TBP, metoda e prodhimit dhe shpenzimeve mund të kombinohen, si për çmimet korrente ashtu edhe për ato të vitit të mëparshëm.

ESA 95, pikat 10.12 deri në 10.23, përcakton se çfarë duhet të përfshihet në “çmim” dhe çfarë në komponentin “volum”.

Komponenti “volum” duhet të përfshijë efektin e ndryshimeve në cilësinë e produkteve. Kjo nënkupton që treguesit e çmimit dhe treguesit e volumit të përdorur për llogaritjen e të dhënave të llogarive kombëtare duhet të korrigjohen me ndryshimet e cilësisë së produktit (quality adjustments – eng).

Konsistenca e rregullimeve të cilësisë të bëra në tregues të ndryshëm duhet të monitorohet. Nëse ekzistojnë dallime të mëdha në indekset e çmimeve për të njëjtin produkt, kjo mund të jetë shkak i metodave të ndryshme të axhsutimit të cilësisë.

Treguesit e volumit duhet të paktën të llogariten në nivel të detajuar produkti, në mënyrë që të merren parasysh ndryshimet strukturore. Për shembull, numri i kilometrave të pasagjerëve në transportin hekurudhor duhet të jetë së paku i ndarë në pasagjerë të klasit të parë dhe të dytë. Kjo lejon përfshirjen e efekteve të variacioneve në çmimet e biletave të klasit të parë dhe të dytë në komponentin e volumit dhe jo në komponentin e çmimit.

Deflatimi i vlerave të vitit aktual duke përdorur një indeks të përshtatshëm çmimesh është metoda më e mirë e vleresimit sesa përdorimi i metodës së ekstrapolimit të vlerave të vitit bazë duke përdorur një indeks volumi (ESA 95, pika 10.32), pasi efektet e ndryshimit të cilësisë janë më të matshme. Për më tepër çmimet relative zakonisht kanë variance më të vogël sesa sasitë relative, duke dhënë një gabim më të vogël kampionimi për indekset e çmimeve.

Nëse vlerat llogariten duke përdorur metodën e “çmimit për sasi”, ky informacion mund të përdoret për llogaritjen e të dhënave me çmimet e vitit të mëparshëm (ESA 95, pika 10.33). Në një rast të tillë, rregullime për cilësinë do të duhet të bëhen.

## **Pjesa tjetër e pjesës së I – rë, e kësaj shtojce, diskuton parime për të cilat ESA 95 ka nevojë për sqarim.**

### ***1.2. Niveli elementar i agregimit të të dhënave***

Matja e çmimeve dhe volumit duhet të fillojë nga një ndarje e detajuar e produkteve për kategori të ndryshme të transaksioneve. Për çdo produkt të dalluar për çdo kategori transaksioni, duhet të ketë një indeks çmimi me të cilin mund të deflatohet vlera aktuale e çmimit, ose duhet gjetur një tregues volumi për të ekstrapoluar një vlerë të vitit bazë.

Megjithatë në praktikën statistikore, është e nevojshme të agregohen produktet, që do të thotë se ndryshimet e çmimit dhe volumit të produkteve të ndryshme duhet të peshohen së bashku. Burimet statistikore nga të cilat është marrë informacion mbi çmimin, llogaritur indekset dhe treguesit e volumit, mund të përdorin metodologji të ndryshme peshimi (d.m.th. formula të ndryshme ose vite bazë të ndryshme). Megjithatë në llogaritë kombëtare, një metodologji e qëndrueshme peshimi për të gjithë variablat duhet të përdoret (për t'u diskutuar në seksionet vijuese). Nëse indekset kanë peshë të ndryshme nga ajo e përdorur në llogaritë kombëtare, atëherë në mënyrë implicite bëhet supozimi se indekset e përdorura janë indekse elementare, kështu që skema e peshimit supozohet të jetë e parëndësishme.

Nje Indeks i Laspeyres i ponderuar me vit bazë fiks, për shembull, mund të supozohet të jetë i barabartë me një indeks Paasche, me Indeks in e ponderuar Laspeyres. Është e qartë se supozimi që indekset e përdorura janë indekse elementare është më i vlefshëm kur zbatohet në një nivel shumë të detajuar. Prandaj, sa më e detajuar të jetë ndarja e produktit, aq më të sakta mund të priten të jenë rezultatet. Në një nivel të detajuar, produktet mund të supozohen të jenë më homogjenë, duke dhënë indekse që janë më afër indekseve elementare, si dhe skema më të detajuara të peshimit. Niveli i grumbullimit të indekseve që është aplikuar në llogaritë kombëtare quhet nivel elementar i grumbullimit. Është shpesh i barabartë me numrin e produkteve të në tabelat e burim - përdorimeve të cilat përdoren për qëllime balancimi.

Shtetet Anëtare duhet të bëjnë përpjekje për të ndërtuar ndarje të detajuara të produkteve për qëllime deflatimi. Niveli elementar i grumbullimit, për prodhimin, si dhe për të gjitha kategoritë e përdorimit (të ndërmjetëm dhe përfundimtar), duhet të jetë të paktën aq i detajuar sa niveli P60 i ESA 95, i cili do të përdoret për paraqitjen e TBP -ve për Eurostatin.

### **Parimi 1:**

Në matjen e çmimeve dhe volumit do të përdoret një nivel i detajuar i grumbullimit të produkteve. Kyniveli i grumbullimit, i cili quhet nivel elementar i grumbullimit, duhet të jetë të paktën po aq i detajuar si niveli P60 i ESA 95, për prodhimin, si dhe për të gjitha kategoritë e përdorimeve (të ndërmjetëme dhe përfundimtare).

### ***1.3. Zgjedhja e formulës së indeksit***

Pas përcaktimit të nivelit elementar të agregimit, indekset e çmimeve dhe volumit të disponueshëm në atë nivel duhet të peshohen së bashku për të marrë matjem e çmimit dhe volumit të të gjithë agregatëve të llogarive kombëtare. Për këtë qëllim, së pari duhet të zgjidhet një formulë e indeksit. ESA 95, pikat 10.62 deri 10.64 shpreh një preference për indekset e çmimeve dhe volumit Fisher, ndërsa indekset e volumit të Laspeyres dhe Paasche japin alternativa të pranueshme. Në praktikë, një indeks Fisher ka disa disavantazhe, ndër të cilat kërkesat me të dhëna më të mëdha, mospërshtatshmëria e të dhënave të volumit dhe shpjegimi më i vështirë për përdoruesit. Prandaj, në praktikë preferohet të përdoren indekset e volumit të Laspeyres dhe të çmimeve Paasche për të përmbledhur çmimin dhe volumet të përfuara në nivelin elementar të grumbullimit.

### **Parimi 2:**

***Vlerat e volumit*** në nivel elementar do të agregohen duke përdorur formulën Laspeyres për të përfutur vlerat e volumit në nivelin e agreguar të llogarive kombëtare. ***Çmimet në nivelin elementar*** do të agregohen duke përdorur formulën Paasche për të përfutur çmimet në nivel të agreguar të llogarive kombëtare. Megjithatë duhet pasur parasysh, se ESA 95 gjithashtu lejon përdorimin e indekseve Fisher. Për më tepër, duhet theksuar se ky parim nuk zbatohet për burimet e të dhënave për çmimet dhe volumet e

përdorura në llogaritë kombëtare: të dhënat në nivelin elementar të agregimit nuk është e nevojshme të llogariten sipas këtij parimi.

#### ***1.4. Zgjedhja e vitit bazë***

Indeksi i volumit Laspeyres përdor vlerat e një viti të caktuar për të peshuar ndryshimet e volumit të komponentëve të një agregati. Duhet të përcaktohet viti për të cilin do të llogariten peshat. Për këtë qëllim, fillimisht duhet të përcaktohen termat “viti bazë” dhe “viti reference”.

Përkufizimet:

- viti bazë është viti për të cilin janë përdorur vlerat e çmimeve aktuale për të peshuar çmimet dhe volume në nivelin elementar të agregimit;
- viti referencë është viti që përdoret për llogaritjen dhe publikimin e të dhënave në çmime të periudhës së mëparshme. Në një seri indeksesh ky është viti që merr vlerën 100.

Për shembull, më poshtë jepet seria e indekseve:

<b>Periudha</b>	<b>1990</b>	<b>1991</b>	<b>1992</b>	<b>1993</b>	<b>1994</b>
Indeksi	100	105	108	112	120

Supozojmë se këto vlera janë llogaritur duke përdorur peshat e vitit 1990. Ky është viti bazë i indeksit. Njëkohësisht viti 1990 është edhe viti referencë, meqë 1990 = 100. Viti referencë mund të ndryshohet lehtësisht, p.sh. 1993 = 100 (pjestohen të gjitha vlerat e indeksit me 100: 112/100 për të marrë 1993 = 100):

<b>Periudha</b>	<b>1990</b>	<b>1991</b>	<b>1992</b>	<b>1993</b>	<b>1994</b>
Indeksi	100/1,12	105/1,12	108/1,12	112/1,12	120/1,12

Një procedurë e tillë nuk e ndryshon vitin bazë, pasi variacionet nga viti në vit llogariten duke përdorur peshat nga viti 1990. Në vend që të kemi një vit bazë fiks si në shembullin e mësipërm, mund të merren çdo vit peshat e vitit të kaluar. Kjo mund të çojë në serinë e mëposhtme të ndryshimeve nga viti në vit:

<b>Periudha</b>	<b>1990</b>	<b>1991</b>	<b>1992</b>	<b>1993</b>	<b>1994</b>
Indeksi	100	105	102	103	106

Për secilin prej këtyre indekseve “t-1 = 100”, **viti referencë** është i barabartë me vitin bazë, por ndryshon çdo vit. Është lehtësisht e mundur të llogaritet seria me vit referencë të ndryshëm. Llogaritja:

**(107,1=105 × 102/100; 110,3=107,1 × 103/100, etj.)**

<b>Periudha</b>	<b>1990</b>	<b>1991</b>	<b>1992</b>	<b>1993</b>	<b>1994</b>
Indeksi	100	105	107,1	110,3	116,9

Është e rëndësishme që, një ndryshim i vitit reference të mos ndikojë në ndryshimin e vlerës së indekseve nga viti në vit. Kjo është e qartë për një seri të vetme si në këtë shembull, por kur një variabël përbëhet nga disa nënvariabla kjo është më e komplekse. Për të mbajtur të pandryshuara normat e rritjes nga viti në vit të çdo variabli kur ndryshohet viti i referencës, duhet çdo variabli t'i ndryshohet vitet referencë, qoftë ky një indeks elementar, apo një agregat i përgjithshëm si PBB-ja. Nqs nuk do të ndryshohej viti reference në nivel elementar, në të dhënat periudhës së mëparshme të çmimeve, do të lindin mospërputhje ndërmjet vlerës së indeksit në nivel të agreguar dhe vlerave në nivel elementar. Ky njihet si problemi i 'jo-aditivitetit'. Këto mospërputhje nuk duhen eliminuar (ESA 95, pika 10.67), pasi kjo do të shtrembëronte sërish normat e rritjes. *Shihni shembullin në fund të këtij seksioni për sqarime të mëtejshme.*

Përcaktimi i vitit bazë dhe vitit referencë në parim është proces i pavarur. Për qëllime të këtij udhëzimi të Komisionit, pra qartësimin e parimeve të llogaritjes së çmimit dhe volumit, është i rëndësishëm vetëm zgjedhja e vitit bazë. Është e qartë se për një krahasueshmëri të vlerës së çmimeve dhe volumeve midis vendeve, duhet të përdoret i njëjti vit bazë. Për më tepër, për norma më të sakta të rritjes, duhet të përdoret viti bazë më i fundit i mundshëm, pasi peshat e përdorura janë më të përditësuara dhe problemet e mosekzistencës së produkteve dhe shtimi i produkteve të reja minimizohen. Te gjitha këto arsyeime çojnë në metodën e zgjedhjes së peshave gjithmonë nga viti i mëparshëm.

### **Parimi 3:**

Vlera e volumeve në nivel elementar të agregimit do të mblidhen duke përdorur peshat e llogaritura nga viti i mëparshëm. Nëse një Shtet Anëtar ka një periudhë kalimtare në lidhje me parimin 3, atëherë ai do të ndryshojë vitin bazë çdo pesë vjet duke filluar nga viti 1995 gjatë periudhës kalimtare.

**Shembull: Rillogaritja e periudhës referencë të indekseve në nivel të agreguar dhe komponentëve të tyre**  
Marrim si shembull dy produkte A dhe B dhe totalin e tyre. Supozojmë se këto janë produkte homogjene, që do të thotë se indekset e çmimeve dhe volumeve për këto produkte mund të llogariten në mënyrë direkte pa përdorur sistemin e peshimit në nivel elementar d.m.th janë indekse elementare. Por volumet dhe indekset e çmimeve për totalin e A dhe B varen nga mënyra se si peshohen A dhe B. Në skemën e mëposhtme ndryshimet e volumit për totalin ndërmjet dy periudhave T-1 dhe T peshohen me vlerat e çmimeve të vitit T-1. Meqenëse këto janë peshat më të përditësuara, normat e rritjes mund të konsiderohen si më të sakta.

	1990 Çmimet korente	Ndryshimi Volumit 90-91	1991 Çmimet 1990	Ndryshimi i Çmimit	1991 Çmime aktuale	Ndryshimi Volumit 91-92	1992 me Çmimet 1991	Ndryshimi i Çmimit 91-92	1992 Çmime korente	Ndryshimi Volumit 92-93	1993 Çmimet e 1992	Ndryshimi Çmimit 92-93	1993 Çmimet korente
A	100	105,0	105	110,0	115,5	102,0	117,8	108,0	127,2	103,0	131,1	105,0	137,6
B	300	110,0	330	95,0	313,5	90,0	282,2	105,0	296,3	95,0	281,4	102,0	287,1
Total	400	108,8	435	98,6	429,0	<b>93,2</b>	400,0	105,9	423,5	<b>97,4</b>	412,5	103,0	424,7



Supozojmë se këto të dhëna duhet të shprehen në një vit referencë fiks, psh. 1990 = 100. Mënyra e vetme për ta bërë këtë pa ndryshuar normat e rritjes së totalit është duke rillogaritur vlerat për vitin reference për çdo produkt veç e veç. Në formë indeksi (1990 = 100) vlerat e llogaritura janë si më poshtë:

	1990	1991	1992	1993
A	100	105,0	107,1	110,3
B	100	110,0	99,0	94,1
Total A+B	100	<b>108,8</b>	<b>101,4</b>	<b>98,8</b>

*Ku:  $101,4=108,8 \times 93,2/100$  dhe  $98,8=101,4 \times 97,4/100$ .*

Për sa i përket volumit në vitin referencë 1990:

	1990	1991	1992	1993
A	100	105,0	107,1	110,3
B	300	330,0	297,0	282,2
Total	400	435,0	405,6	395,0
A+B	400	435,0	404,1	392,5

Është e qartë se shuma e A dhe B nuk është më e barabartë me totalin. Ky është problemi i njohur i jo-aditivitetit. Pavarësisht këtij problemi, volumi 'korrekt' për vitin 1993 është 395,0 dhe jo 392,5, sepse kjo është e vetmja shifër që përputhet me ritmet e rritjes së llogarituar më parë të totalit. Për më tepër, në këtë mënyrë ritmet e rritjes nga viti në vit nuk do të ndryshojnë me ndryshimin e vitit referencë. Mospërputhjet midis A, B dhe totalit të tyre nuk duhet të hiqen, por t'u shpjegohen përdoruesve. Këto mospërputhje nuk mund të interpretohen si tregues të besueshmërisë së rezultateve.

## PJESA II

### MATJA E ÇMIMEVE DHE VOLUMIT SIPAS METODËS SË PRODHIMIT

#### II.1. Klasifikimi i metodave

Klasifikimi i mëposhtëm i metodave do të përdoret gjatë pjesës së mbetur të kësaj shtojce:

Metodat A: metodat më të përshtatshme;

Metodat B: ato metoda që mund të përdoren në rast se një metodë A nuk mund të zbatohet;

Metodat C: ato metoda që nuk do të përdoren.

#### II.2. OUTPUT-i i Tregut dhe OUTPUT-i për përdorim final vetjak

Në këtë seksion janë marre parasysh llogaritjet për Outputin e Tregut dhe Outputin për përdorim final vetjak. Së pari, janë dhënë disa parime në lidhje me metodat e ndryshme të llogaritjes së vlerës së shtuar me çmime periudhës së mëparshme. Këto parime ofrojnë kriteret e përgjithshme të klasifikimit të metodave të

llogaritjes në metoda: A, B dhe C. Megjithatë, këto parime duhet së pari të zbatohen fillimisht për secilin produkt më vete, për të gjitha llojet e prodhimit të tregut, duke dhënë udhëzime specifike mbi metodat që duhen zbatuar në secilin rast.

Lidhur me zgjedhjen midis metodave me tregues të dyfishtë dhe një treguesi të vetëm, jepet klasifikimi i mëposhtëm:

**Metoda A:** ESA 95 thotë qartë (pika 10.28) se deflatimi i dyfishtë është teorikisht metoda e saktë, meqenëse vlera e shtuar me çmime korente vlerësohet si diferencë midis prodhimit dhe konsumit ndërmjetës. Ky argument vlen në fakt për të gjitha metodat e treguesve të dyfishtë (p.sh. ekstrapolimi i Outputit me një tregues volumi dhe deflatimi i konsumit të ndërmjetëm). Ka disa arsye të tjera që mund të përmenden pse preferohen metodat me deflatim të dyfishtë:

- treguesit që përdoren janë tregues të Outputit ose të Inputit. Në metodat me tregues të vetëm, tregues të tillë zbatohen direkt mbi vlerën e shtuar gjë e cila nuk është e përshtatshme;
- metodat me tregues të dyfishtë japin një vlerësim të pavarur të ndryshimeve të produktivitetit.

**Metoda B:** Në praktikë mund të jetë e nevojshme të përdoren metoda të bazuara në tregues të vetëm, për shkak të të dhënave të pamjaftueshme për konsumin e ndërmjetëm, ose sepse besueshmëria e të dhënave është e pamjaftueshme.

Lidhur me përshtatshmërinë e treguesve për t'u përdorur në deflatimin e vlerave të vitit korent ose në deflatimin e vlerave korente ose ekstrapolimin e vlerave të vitit bazë, mund të përdoren kriteret e mëposhtme:

- plotshmëria e fushës së mbulimit të produktit. Për shembull, nëse treguesi mbulon të gjitha produktet ose vetëm një përzgjedhje të tyre, të tilla si “vetëm ato produkte që u shiten familjeve”;
- baza e vlerësimit të treguesit. Për Outputin e tregut, duhet të përdoren çmimet bazë për shembull çmimet e blerjes ose kostot e lëndës së parë;
- treguesi duhet të marrë parasysh ndryshimet e cilësisë, duke i regjistruar ato brenda vlerësimeve të volumit;
- konsistencën konceptuale ndërmjet treguesve të llogaritur dhe koncepteve të llogarive kombëtare.

Këto kritere çojnë në konkluzione të përgjithshme për përshtatshmërinë e treguesve, por, siç u tha më sipër, këto përfundime të përgjithshme duhet të zbatohen më pas për çdo produkt, për të gjitha llojet e prodhimit të tregut, mbështetur në udhëzime specifike për metodat që duhen zbatuar në secilin rast.

Kriteret e mëposhtme për dallimin e metodave A, B dhe C janë kritere absolute, pra nuk varen nga disponueshmëria e të dhënave. Në praktike mund të ndodhë që metodat A nuk janë të arritshme dhe duhet të aplikohen metodat B.

**Metoda A:** Në metodën e prodhimit, në parim, përdorimi i indekseve të përshtatshme të çmimeve të prodhimit, zakonisht të referuara si Indekset e Çmimeve të Prodhimit (ICPs), do të jetë metoda A. Çdo

produkt duhet të deflatohet veçmas nga një IÇP respektive. Një IÇP respektive plotëson kriteret e mëposhtme:

- është një indeks i çmimi (ve) (të vendit dhe të eksportit) të atij (grupi) produkti (eve);
- merr parasysh ndryshimet në cilësinë e produktit (eve), vlerësohet me çmime bazë, konceptet e tij themelore janë në përputhje me konceptet e llogarive kombëtare.

Çdo metodë që mund të tregohet se është plotësisht ekuivalente me përdorimin e IÇP-ve mund të shihet gjithashtu si një metodë A.

**Metoda B:** Nëse një IÇP respektive për një product (grup produkte) nuk është e disponueshme, ekzistojnë disa lloje alternative të treguesve. Për shembull, metodat e mëposhtme zakonisht do të jenë metoda B:

- një IÇP më pak i përshtatshëm, p.sh. një indeks pa korrektime cilësore, ose që ka një mbulim më të vogël ose më të madh sesa produkti që duhet deflatuar;
- një Indeks i Çmimeve të Konsumit (IÇK). Të njëjtat kritere si për IÇP-të zbatohen dhe për IÇK (IÇK-të normalisht duhet të korrektohen për taksat, subvencionet dhe marzhet për të marrë vlerësimin në çmimet bazë), dhe përveç kësaj, peshimi duhet të jetë i përshtatshëm dhe konceptet duhet të korrespondojnë me konceptet e llogarive kombëtare
- treguesit e volumit të outputit. Treguesit e volumit gjithashtu duhet të marrin parasysh ndryshimet e cilësisë. Kjo mund të bëhet pjesërisht duke zbatuar treguesit e volumit në nivel të mjaftueshëm detajimi në mënyrë që të merren në konsideratë ndryshimet strukturore.

Tregues të tillë në përgjithësi nuk përmbushin të katër kriteret e përcaktuara më sipër.

**Metoda C:** Përdorimi i disa treguesve të tjerë të mundshëm, si më poshtë, zakonisht do të jenë metoda C.

- metodat e inputit (për outputin e tregut),
- tregues dytësorë, d.m.th. tregues që nuk lidhen drejtpërdrejt me prodhimin,
- IÇP, IÇK ose treguesi i volumit që nuk korrespondojnë me produktin (et) në fjalë, p.sh. IÇK gjithsej.

Tregues të tillë, në përgjithësi, janë shumë larg respektimit të katër kriterëve, shumë më tepër sesa metoda B. Në vijim këto kritere do të zbatohen për produktet e çdo kreu të NP (Klasifikimi i Produkteve sipas Aktivitetit Ekonomik). Prodhimi i tregut dhe prodhimi për përdorim përfundimtar vetjak do të trajtohen së bashku. ESA 95, pika 3.49 thotë se "prodhimi për përdorim përfundimtar vetjak duhet të vlerësohet me çmimet bazë të produkteve të ngjashme të shitura në treg". Prandaj, parimet për deflatimin e prodhimit për përdorim përfundimtar vetjak janë të njëjta si për prodhimin e tregut.

Për çdo lloj produkti, qëllimi është të përcaktohen metodat A, B dhe C. Nëse, për një produkt të caktuar, përdorimi i IÇP-ve nuk paraqet probleme specifike (d.m.th. metoda A është e realizueshme), nuk diskutohet mënyra me të cilën tregues të tjerë të veçantë plotësojnë kriteret. Për një numër të konsiderueshëm të llojeve të produkteve nuk është ende e mundur të përcaktohen metodat A, B dhe C. Kjo do të bëhet në kuadër të

programit kërkimor. Programi kërkimor mundëson gjithashtu përmirësime të mëtejshme të klasifikimeve për ato produkte për të cilat është dhënë më poshtë një klasifikim fillestar.

Ky dokument trajton kryesisht vlerësimin e prodhimit me çmime të periudhës së mëparshme. Për metodat e deflatimit të dyfishtë, duhet deflatuar gjithashtu edhe konsumi i ndërmjetëm. Metoda e preferuar e deflatimit të konsumit të ndërmjetëm është deflatimi për çdo produkt në vecanti, duke përdorur të dhëna reale të çmimeve për përdorimet e ndërmjetme, të mbledhura nga blerësit. Megjithatë, kjo në praktikë shpesh nuk është e mundur. Prandaj, konsumi i ndërmjetëm i produkteve të prodhuara në vend mund të deflatohet duke përdorur të njëjtën metodë siç përshkruhet më poshtë për prodhimin e atij produkti, duke marrë parasysh diferencën në vlerësim (konsumi i ndërmjetëm vlerësohet në çmimet e blerjes). Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet deflatimit të konsumit të ndërmjetëm të produkteve të importuara. Për më tepër, duhet të merren parasysh dallimet në çmime për përdorues të ndryshëm. Një shembull i tillë është energjia elektrike, për të cilën ekzistojnë ndryshime të mëdha të çmimit për përdorues të ndryshëm.

Kur merret parasysh vlerësimi i konsumit të ndërmjetëm me çmimet e periudhës së mëparshme, një faktor i rëndësishëm që duhet marrë në konsideratë është ndikimi i vlerësimeve jo të besueshme të prodhimit me çmimet e periudhës së mëparshme (p.sh. për një aktivitet shërbimi) i cili mund të ulet në nivelin e PBB-së gjithsej me çmimet e periudhës së mëparshme. Në kuadër të metodës së prodhimit ndikimi i deflatorëve jo të besueshëm ose deflatorëve të nënkuptuar për disa produkte në vlerësimet e PBB-së gjithsej me çmimet e periudhës së mëparshme minimizohen nëse:

- llogaritë me çmimet e periudhës së mëparshme përpilohen në kuadrin e tabelës së burim-përdorimeve; metodat e deflatimit të dyfishtë përdoren në të gjithë llogaritë;
- çdo deflator jo i besueshëm për deflatimin e prodhimit përdoret gjithashtu për deflatimin e konsumit të ndërmjetëm.

Përdorimi i tabelës së burim - përdorimeve për integrimin e vlerësimeve, i kombinuar me deflatimin e dyfishtë, luan një rol të rëndësishëm në minimizimin e pasaktësive në nivelin e PBB-së gjithsej me çmimet e periudhës së mëparshme.

**NP A: Produktet e bujqësisë, gjuetisë dhe pyjeve****NP B: Peshku**

Shumica e llogaritjeve të çmimeve korente për këto produkte bazohen në informacionin e çmimit dhe sasisë. Për këtë arsye, mund dhe duhet të përdoret ky informacion për të llogaritur prodhimin me çmimet e periudhës së mëparshme. Informacioni sasior duhet të korrigjohet me ndryshimet e cilësisë kudo që është e përshtatshme. Në disa raste, përpilohen edhe IÇP-të respektive. Të gjitha këto metoda janë metoda A.

**NP C: Produkte të industrisë nxjerrëse; NP D: Produkte të industrisë përpunuese; NP E: Energjia elektrike, gazi, avulli dhe uji i nxehtë**

Për këto tre grup produktesh, Shtetet Anëtare transmetojnë IÇP në Eurostat. Përdorimi i IÇP-ve, nëse plotësohen kriteret e sipërpërmendura, është metodë A për këto produkte. Këto të dhëna më pas duhet të përdoren në llogaritjet e çmimeve të periudhës së mëparshme.

Ka disa probleme të rëndësishme në matjen e çmimit dhe volumit të produkteve specifike. Kjo lidhet veçanërisht për:

- kompjuterat dhe pajisje të tjera të përpunimit të informacionit
- makineri dhe pajisje të mëdha, si avionë dhe anije.

Për këto produkte matja e çmimit është zakonisht shumë e vështirë, ndërsa ekonomikisht janë mjaft domethënëse. Përmirësimi i procedurave për këto produkte duhet të studiohet në programin e kërkimit.

**NP F: Ndërtimi**

Për aktivitetin e ndërtimit, matja e çmimit dhe e volumit shpesh ndërlikohet nga karakteri i njëanshëm i produkteve. Problemet metodologjike të vlerësimit të prodhimit të ndërtimit me çmimet e periudhës së mëparshme duhet të studiohen nga programe kërkimi.

**NP G: Shërbime të tregtisë me shumicë dhe pakicë, shërbime riparimi të automjeteve, motoçikletave dhe mallrave personale dhe shtëpiake.**

- **50: Shërbimet e shitjes, mirëmbajtjes dhe riparimit të automjeteve dhe motoçikletave; shërbimet e tregtisë me pakicë të karburanteve të automobilave:** Ky grup përbëhet nga dy lloje produktesh:
  - prodhimi i aktivitetit të mirëmbajtjes dhe riparimit të automjeteve dhe motoçikletave;
  - prodhimi i marzhit tregtar nga shitja e mjeteve motorike, motoçikletave dhe karburantit të automobilave.

Për llojin e parë të prodhimit, mund të jenë të disponueshme IÇP-të dhe konsiderohet metodë A e vlersimit. Nëse nuk janë të disponueshme IÇP -të, produktet mund të deflatoohen duke përdorur IÇK-të (të korrektuara për çdo taksë ose subvencion), të cilat janë një metodë B, sepse mund të mos mbulojë mjaftueshëm shpenzimet e ndërmarrjes.

Për deflatimin e marzheve tregtare duhet të zbatohen të njëjtat procedura siç përshkruhet më poshtë për tregtine me shumicë.

- **51: Tregtia me shumicë dhe shërbime të tregtisë me shumicë, me përjashtim tregtimin e automjeteve dhe motoçikletave.** Prodhimi kryesor i këtij grupi përbëhet nga marzhet e tregtisë me shumicë. Për llogaritjen e marzhit, mund të specifikohen rregullat si më poshtë:

**Metoda A:** Metoda A për prodhimin e marzhit është një metodë që merr parasysh në llogaritje ndryshimet në cilësinë e shërbimeve tregtare. Kjo mund të arrihet duke deflatuar veçmas shitjet dhe blerjet e tregtarëve (llogaria e ndryshimeve në inventarë). Për këtë, kërkohen indekse çmimesh të një cilësie shumë të mire.

**Metoda B:** Metoda B mund të përdoret duke bërë supozimin se volume i marzheve është i njëjtë me volumin e të ardhurave nga shitja. Kjo supozon se përqindjet e marzhit në periudhën e mëparshme janë të pandryshueshme. Mënyra më e thjeshtë për ta zbatuar këtë është ekstrapolimi i prodhimit të marzhit gjithsej në një indeks volumi të shitjeve. Indeksi i volumit të të ardhurave nga shitja mund të perftohet duke deflatuar të ardhurat nga shitja me indeksin e çmimit të të ardhurave nga shitja. Kjo metode e thjeshte mund të përmirësohet duke shtuar nivelin e detajimit të produktit, mundësisht duke llogaritur marzhin tregtar me çmimet e periudhës së mëparshme në tabelë e burim përdorimeve. Raporti i marzhit të një transaksioni të vecantë i llogaritur për një vit të caktuar bazë mund të zbatohet për volumin e atij transaksioni në viti aktual. Në këtë mënyrë volumi i marzhit rritet me volumin e fluksit të mallrave. Një përmirësim tjetër është marrja parasysh e ndryshimeve në kanalet tregtare (p.sh. kalimi nga njësitë e vogla të tregtimit në hipermarketet e mëdha). Kjo do të përfshinte një pjesë të ndryshimit cilësor të shërbimeve tregtare në komponentin e volumit. Metoda të tilla duhet të konsiderohen si metoda B, pasi ndryshimi i cilësisë së shërbimit tregtar nuk mund të merret në konsideratë.

**Metoda C:** Çdo metodë tjetër, p.sh. deflatimi i prodhimit të marzhit direkt nepermjet indeksit të çmimit të të ardhurave nga shitja.

- **52: Shërbimet e tregtisë me pakicë, me përjashtim të automjeteve dhe motoçikletave; riparimi i produkteve për përdorim personal dhe shtëpiak.** Për prodhimin e marzhit të tregtisë me pakicë, duhet të përdoret i njëjti supozim siç është përshkruar më sipër për tregtinë me shumicë. Një avantazh këtu është se ekziston një matje e mirë e indeksit të çmimit të të ardhurave nga shitja me pakice: IÇK. Për të marrë indeksin e volumit të tregtisë me pakicë të një malli të caktuar, artikulli respektiv i IÇK-së mund të përdoret për të deflatuar. Për prodhimin e riparimit të produkteve për përdorim personal dhe shtëpiak, mund të përdoret IÇK dhe mund të konsiderohet si një metodë A. Megjithatë, produkte të ndryshëm të IÇK-së do të duhet të përdoren pasi këtu përfshihen produkte të ndryshme . Prandaj, deflatimi është i nevojshëm në nivel të detajuar.

**NP H: Shërbimet e hotelarisë dhe restoranteve**

**Metoda A** për hotelet dhe restorantet është deflatimi me një IÇP të përshtatshme. Në rast se një IÇP nuk ekziston, IÇK mund të përdoret si një përafrim. Kjo është në këtë rast një metodë B, pasi nuk merren në konsideratë shpenzimet e ndërmarrjes.

**NP I: Shërbimet e transportit, magazinimit dhe komunikimit**

- **60, 61 dhe 62: Transporti nga toka, uji dhe ajri**
- **Transporti i pasagjerëve dhe i mallrave duhet të deflatohet me vete.**

**Për transportin e udhëtarëve**, metoda A është përdorimi i IÇP-ve të përshtatshme. Në rast se ato nuk janë të disponueshme, metodat e mëposhtme janë metoda B:

- deflatimi me IÇK me kusht që të marrë në konsideratë ndryshimet cilësore;
- ekstrapolimi nga një tregues i numrit të kilometrave të pasagjerëve, me kusht që ky tregues të jetë i disponueshëm për një numër të mjaftueshëm të kategorive të transportit. Të paktën duhet bërë një dallim midis klasave të ndryshme (p.sh. klasi i parë dhe i dytë për transportin hekurudhor, klas biznesi dhe e zakonshme për transportin ajror, etj.).

Këto metoda duhet të zbatohen individualisht për të paktën llojet e mëposhtme të transportit (pasagjerësh), për sa kohë që ato janë të rëndësishme në Shtetet Anëtare:

- transporti hekurudhor;
- lloje të tjera të transportit tokësor;
- transporti ujor;
- transporti ajror.

Nëse këto ndarje nuk arrihen, atëherë çdo metodë tjetër (p.sh. përdorimi i numrit të pasagjerëve si tregues volumi) është metodë C.

**Për transportin e mallrave** përdorimi i IÇP-ve të përshtatshme konsiderohen metoda A. Nëse ato nuk janë të disponueshme, atëherë metoda e mëposhtme është një metodë B:

- mund të supozohet se volumi i shërbimit të transportit ndjek volumin e mallrave të transportuara.

Për

për këtë qëllim, një tregues si ton-kilometra e transportuar është i përshtatshëm, megjithëse nuk mund të merren në konsideratë ndryshimet cilësore në shërbimin e transportit. Sa më shumë detaje të kemi në dispozicion për ton-kilometra të llojeve të ndryshme të transportit, aq më i mirë do të jetë rezultati.

Kjo metodë duhet të zbatohet individualisht për të paktën llojet e mëposhtme të transportit (mallrave), për sa kohë që ato janë të rëndësishme në Shtetet Anëtare:

- transporti nëpërmjet hekurudhave;
- transport tjetër tokësor;
- transporti nëpërmjet tubacioneve;

- transporti ujq detar dhe bregdetar - transporti ujq i brendshëm;
- transport ajror.

Nëse këto ndarje nuk arrihen, çdo metodë tjetër (p.sh. përdorimi i një treguesi të tillë si tonelatat e transportuara) është metodë C.

Si për transportin e pasagjerëve ashtu edhe për transportin e mallrave, në parim, një deflatim i saktë kërkon si pesha të dhënat në çmime korente për klasifikimet e mësipërme. Nëse ky nivel detajimi nuk është i disponueshëm në çmimet korente, mund të përdoren pesha të tjera për të peshuar treguesit për secilin nga llojet e transportit. Këto pesha të tjera duhet të përafrojnë vlerat korente sa më afër që të jetë e mundur.

- **63: Shërbimet mbështetëse dhe ndihmëse të transportit; shërbimet e agjencive të udhëtimit.** Ky grup mbulon një shumëllojshmëri të gjerë shërbimesh, prandaj nuk është e mundur të specifikohet një metodë ose tregues i veçantë. Prandaj, i referohet klasifikimit të përgjithshëm të metodave dhe treguesve. Për agjencitë e udhëtimit, ESA 95 bën rekomandime specifike (shih pikën 10.39).
- **64: Shërbimet e postës dhe telekomunikacionit.** Vlerësimi i shërbimeve të postës dhe telekomunikacionit me çmime të periudhës së mëparshme është i ndërlikuar nga gama gjithnjë në rritje e llojeve të ndryshme të shërbimeve të ofruara dhe tarifave të aplikuara. Për këtë arsye, si pjesë e programit kërkimor do të zhvillohen udhëzime specifike mbi metodat që do të përdoren për këto produkte.

### **NP J: Shërbimet e ndërmjetësimit financiar**

Për produkte të tilla si shërbimet e ndërmjetësimit financiar të matura në mënyrë indirekte (FISIM), letrat me vlerë, kurset e këmbimit dhe sigurimet, prodhimi me çmime korente përkufizohet si balanca ndërmjet transaksioneve të ndryshme. Duhet të specifikohet një përkufizim dhe matje e harmonizuar e prodhimit me çmime të periudhës së mëparshme.

Marrja në konsideratë e ndryshimeve cilësore në shërbimet financiare dhe të sigurimit është një çështje tjetër që kërkon shqyrtim të mëtejshëm, siç është krahasueshmëria e vlerësimeve për shërbimet financiare për të cilat aplikohen çmime direkte. Udhëzime specifike mbi praktikën që do të përdoren për këto produkte do të zhvillohen si pjesë e programit të kërkimit.

### **NP K: Shërbime për pasuri të paluajtshme, dhënie me qira dhe shërbimet e biznesit**

- **Shërbimet për pasuri të paluajtshme**



Për vlerësimin e prodhimit të shërbimeve të pasurive të paluajtshme me çmimet korente, të gjitha Shtetet Anëtare do të përdorin të ashtuquajturën metodë shtresëzimi për të matur prodhimin për qëllime të PBN-së (prodhimi i brendshëm neto) deri në vitin 1998 ose 1999 (1).

Nëpërmjet kësaj metode prodhimi me çmimet korente vlerësohet në një mënyrë objektive duke përdorur të dhëna për sasinë dhe cilësinë e banesave dhe çmimet e paguara për përdorimin e tyre. Prandaj si rrjedhojë do të nevojitet informacion mbi çmimin e outputit për të bërë deflatimin. I njëjti informacion mbi çmimin, cilësinë dhe sasinë duhet të përdoret për të prodhuar vlerësime me çmimet e periudhës së mëparshme. Zbatimi i metodës së përshkruar më sipër mund të përshkruhet si metoda A. Ai jep mundësinë për të marrë në konsideratë ndryshimet cilësore në shërbimet e banimit.

**- Shërbime të tjera të dhënies me qera, pasuri të paluajtshme dhe shërbime të biznesit**

Për këto shërbime, të dhënat e çmimeve të prodhimit mund të jenë të vështira për t'u mbledhur, për shkak të natyrës së njëanshme të disa prej produkteve. Si pasojë, në vend të tyre mund të përdoren alternative të ndryshimeve të çmimit ose volumit, metoda indirekte. Përshtatshmëria e këtyre matjeve indirekte duhet të vlerësohet për çdo shërbim nën këtë aktivitet. Udhëzimet specifike do të zhvillohen si pjesë e programit të kërkimit. Vëmendje e veçantë në programin e kërkimit duhet t'i kushtohet deflatimit të prodhimit të softuerëve, i cili gjithashtu përfshihet në këtë grup produktesh.

**NP M: Shërbimet arsimore; NP N: Shërbimet shëndetësore dhe sociale**

Në disa Shtete Anëtare pjesët kryesore të ofrimit të shëndetësisë dhe arsimit regjistrohen si prodhim tregu, ndërsa disa të tjerë i regjistrojnë si prodhime jo tregu. Metodatat e nevojshme për të matur prodhimin në çmimet e periudhës së mëparshme duhet të marrin parasysh nevojën për të patur statistika të krahasueshme për të dy grupet e vendeve. Statistikat e çmimeve për deflatimin e prodhimit të tregut duhet të pasqyrojnë çmimin gjithsej të produktit, jo vetëm kontributin e konsumatorit ndaj çmimit gjithsej ose një tarifë fikse. Statistikat e çmimeve duhet gjithashtu të lejojnë ndryshime cilësore në produktet shëndetësore dhe arsimore. Udhëzime specifike mbi praktikatat që do të përdoren për këto produkte, duke përdorur statistikat e çmimeve ose metoda të tjera, do të zhvillohen si pjesë e programit të kërkimit. Programi do të mbulojë si prodhimin tregtar të këtyre shërbimeve ashtu edhe, siç përshkruhet më poshtë, prodhimin jo tregtar të tyre.

**NP O: Shërbime të tjera komunitare, sociale dhe personale**

Për këto shërbime të dhënat e çmimeve të prodhimit shpesh nuk janë të disponueshme dhe zakonisht përdoren tregues alternative. Ashtu si me shëndetësinë dhe arsimin, mund të ketë prodhim tregu dhe jo tregu për disa nga aktivitetet. Dhe për këtë duhet të merren në konsideratë metodatat statistikore. Udhëzime specifike mbi praktikatat që do të përdoren për këto produkte do të zhvillohen si pjesë e programit të kërkimit.

**NP P: Familjet me persona të punësuar**

Ky prodhim, i cili është prodhim për përdorim përfundimtar vetjak, vlerësohet me marrëveshje si kompensim i punonjësve, duke përfshirë çdo të ardhur në natyrë.

Metodat e zakonshme për prodhimin e vlerësimeve me çmimet e periudhës së mëparshme janë përdorimi i të dhënave të IÇK-së ose të dhënave të pagave për deflatim, ose ekstrapolimim me indekse volumi (me numrin e punonjësve të përdorur si ekstrapolues). Në parim, deflatorët e përdorur (të dhënat e IÇK-së ose të pagave) duhet të verifikohen për t'u siguruar që ato marrin në konsideratë të ardhurat në natyrë. Këto metoda nuk marrin parasysh ndryshimet e produktivitetit, por ky marrëzh gabimi do të ketë vetëm pasoja të vogla për PBB-në. Metoda të tilla janë metoda B, përveçse kur marrin parasysh ndryshimet e produktivitetit (në këtë rast ato janë metoda A).

### **Taksat dhe subvencionet mbi produktet dhe importet dhe TVSH**

ESA 95, pikat 10.47 deri në 10.52, parashtrojnë me detaje parimet që duhen përdorur për të vlerësuar taksat dhe subvencionet për produktet vendase, importet dhe TVSH me çmimet e periudhës së mëparshme. Këto parime përfaqësojnë metoden A.

### **II.3. Prodhimi jo tregtar**

Metodat statistikore për matjen e prodhimit me çmimet e periudhës së mëparshme duhet të sigurojnë prodhimin e statistikave të krahasueshme si për prodhimin tregtar ashtu edhe për atë jo-tregtar, veçanërisht për aktivitete e shërbimeve si arsimit dhe shëndetësia. Për shërbimet jo-tregtare, prodhimi me çmimet e periudhës së mëparshme mund të vlerësohet duke përdorur ose tregues të volumit të prodhimit ose metoda të inputeve (për shembull, deflatimi i inputeve të punës dhe inputeve të tjera, ose ekstrapolimi i volumit të vitit bazë të inputeve të punës). Mund të ekzistojnë gjithashtu disa të dhëna për çmimet. Dallimi midis metodave A, B dhe C për matjen e prodhimit jo për qëllime tregu të aktiviteteve të shërbimeve do të përcaktohet nëpërmjet programit të kërkimit.

#### **II.3.1. NP M: Arsimit**

Prodhimi jo për qëllime tregu i aktivitetit të “Arsimit” me çmimet e periudhës së mëparshme mund të vlerësohet duke përdorur ose tregues të volumit të prodhimit ose metoda të inputit. Udhëzues specifik mbi metodat që do të përdoren për vlerësimin e outputit (qoftë me anë të treguesve të volumit të prodhimit, metodave të inputeve, ose, për prodhimin e tregut të të dhënave të çmimeve) do të zhvillohen si pjesë e programit të kërkimit. Ky program gjithashtu do të marrë në konsideratë ndryshimet e cilësisë së produkteve.

#### **II.3.2. NP N (pjesa): Shëndetësia**

Prodhimi i shërbimeve shëndetësore jo-tregtare me çmimet e periudhës së mëparshme mund të vlerësohet gjithashtu duke përdorur treguesit e volumit të prodhimit ose metodat e inputit. Udhëzues specifik mbi metodat që do të përdoren për vlerësimin e outputit në shëndetësi (qoftë me anë të treguesve të volumit të prodhimit, metodave të inputeve, ose, për prodhimin e tregut, të dhënave të çmimeve) do të zhvillohen si pjesë e programit të kërkimit. Ky program gjithashtu do të marrë në konsideratë ndryshimet e cilësisë.

### **II.3.3. Prodhimi jo - tregtar i aktiviteteve të tjera të shërbimeve**

Produktet e tjera jo-tregu mund të marrin forma të ndryshme. Disa ofrohen në baza individuale (p.sh. shërbimet e sigurimeve shoqërore), ndërsa të tjerat ofrohen në baza kolektive (p.sh. shërbimet e mbrojtjes). Ndërsa të tjerë mund të kenë si element individual ashtu edhe atë kolektiv (p.sh. shërbimet policore - të klasifikuara me marrëveshje në shërbimet kolektive sipas ESA 95).

Treguesit e volumit të prodhimit mund të përdoren për të vlerësuar prodhimin e shërbimeve të ofruara në baza individuale dhe, disa nga shërbimet e ofruara në baza kolektive. Metodave të inputeve mund të përdoret për të gjithë këto shërbimet. Rezultatet e krahasueshme do të kërkojnë harmonizimin e mënyrës në të cilën zbatohen të dy metodat. Udhëzime specifike mbi metodat që do të përdoren për këto produkte (qofshin treguesit e volumit të prodhimit ose metodat e inputit) do të zhvillohen si pjesë e analizave statistikore.

## **PJESA III**

### **MATJA E ÇMIMEVE DHE VOLUMEVE SIPAS METODES SË SHPENZIMEVE**

Nga ana e shpenzimeve, PBB-ja me çmimet e periudhës së mëparshme është shuma e konsumit përfundimtar, formimin bruto të kapitalit dhe eksporteve neto. Për sa i perket përshtatshmërisë së treguesve që do të përdoren si deflatimin e vlerave në çmimet e vitit aktual ose ekstrapolim të vlerave me çmimet e vitit bazë me metodën e shpenzimeve, mund të përdoren kriteret e mëposhtme:

- mbulim i plotë i produktit, për shembull, treguesi mbulon të gjitha produktet ose vetëm një pjesë të tyre;
- Për konsumin përfundimtar dhe formimin e kapitalit bruto duhet të përdoren çmimet e blerjes dhe jo ato të prodhimit;
- treguesi duhet të marrë parasysh ndryshimet e cilësisë, duke i regjistruar ato me vlerësimet e volumit dhe jo në vlerësimet e çmimeve;
- Përputhshmëria konceptuale ndërmjet treguesit dhe koncepteve të llogarive kombëtare.

Këto kritere çojnë në konkluzionet e përgjithshme të mëposhtme në lidhje me procedurat e vlerësimit të matjeve të çmimit dhe volumit në kategoritë e ndryshme të metodës së shpenzimeve.

### **Konsumi përfundimtar i familjeve**

Konsumi përfundimtar i familjeve (HFCE - eng) duhet, aty ku është e përshtatshme, të deflatohet duke përdorur informacionin nga IÇK.

IÇK-ja mund të thuhet se është e përshtatshme nëse plotëson kriteret e mëposhtme:

- indeks me mbulim të atij (grupi) produkti(ve),
- merr parasysh ndryshimet në cilësinë e produktit(ve) ,
- vlerësohet në çmimet e blerjes duke përfshirë TVSH-në,
- konceptet bazë të IÇK-së duhet të jenë të njëjta me ato të llogarive kombëtare.

Nëse IÇK - ja nuk është i disponueshëm për një produkt të caktuar, atëherë duhet të përdoren tregues të tjerë, më të përafërt. Këto mund të jenë IÇP, indekse të çmimeve të eksportit, importit ose tregues të volumit. Metoda të tilla janë metoda B.

Metodat C përfshijnë përdorimin e indekseve që nuk korrespondojnë fare me produktin (et) në fjalë.

### **Konsumi përfundimtar i qeverisë (GFC - eng) dhe konsumi përfundimtar i NPISH-ve.**

Për këta komponentë të konsumit përfundimtar mund të bëhen të njëjtat vlerësime si për vlerësimin e prodhimit jo tregtar me metodën e prodhimit, (Seksioni II.3), pasi vlerat e mallrave dhe shërbimeve të prodhuara nga qeveria e përgjithshme dhe NPISH janë përbërësit kryesorë të këtyre kategorive (ESA 95, pikat 3.78 dhe 3.79).

Blerjet nga qeveria të mallrave dhe shërbimeve të prodhuara nga prodhuesit e tregut, të cilat u ofrohen familjeve - pa asnjë transformim – si transferta sociale në natyrë, të cilat janë gjithashtu pjesë e konsumit përfundimtar të qeverisë (ESA 95, pika 3.79), duhet të deflatohen nëpërmjet indekseve të përshtatshme të çmimeve për këto mallra dhe shërbime (të tregut). ESA 95, pika 3.85 përshkruan dallimin ndërmjet mallrave dhe shërbimeve individuale dhe kolektive të ofruara nga qeveria. Kur bëhet ky dallim, atëherë marrim konceptin e konsumit përfundimtar korent. Ky përfaqësim i llogarive nuk krijon problem specifik në lidhje me vlerësimet në çmimet e periudhës së mëparshme.

### **Formimi bruto i kapitalit fiks**

Për formimin bruto të kapitalit fiks (GFCF - eng) metoda A është përdorimi i indekseve të çmimeve të mirëfillta të investimeve. Një indeks i tillë duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

- të jetë indeks me mbulim të saktë të këtij (grupi) produkti(ve),
- të marrë në konsideratë ndryshimet në cilësinë e produktit(ve),
- vlerësohet në çmimet e blerjes duke përfshirë TVSH-në e pazbritshme,
- konceptet bazë të indeksit duhet të jenë të njëjta me ato të llogarive kombëtare.

Në praktikë shpesh do të përdoren IÇP-të, të cilat janë metoda B nëse nuk rivlerësohen në çmimet e blerjes. Për IÇP-të e produkteve specifike, zbatohen të njëjtat kritere si në seksionin II.2, duke përfshirë referencat për kërkim – zhvillimin.

### **Ndryshimet në inventarë**

Është e rëndësishme që gjendjet inventar të deflatohen në mënyrë specifike dhe të pavarur, të mos llogariten si zëri i mbetur i llogaritjet ne çmime te vitit të mëparshëm.

ESA 95, pika 10.56 thotë se ndryshimet në inventar me çmime te vitit të mëparshëm mund të llogariten duke i deflatuar hyrjet dhe daljet nga inventarët veçmas me indeksat e duhura të çmimeve. Kur ndryshimet e volumit dhe çmimit të inventareve nuk janë shumë të mëdha, deflatimi i drejtpërdrejtë i ndryshimit të inventarëve me një indeks mesatar te çmimeve te vitit ofron nje alternative.

Ekzistojnë katër lloje inventarësh (ESA 95, pika 3.119):

- materialet dhe furnizimet: të njëjtat parime mund të shprehen këtu siç u deklaruan për deflatimin e
- konsumi i ndërmjetëm në Seksionin II.2
- punë në proces: kjo kategori duhet të hetohet në programin e kërkimit, — mallrat e gatshme: këto mund të deflatohen duke përdorur IÇP me çmime bazë,
- mallra për rishitje: këto vlerësohen në çmimet me të cilat janë blerë, për të cilat IÇP shpesh është një tregues i mirë.

**Fitimi i pashpërndare** duhet gjithashtu të analizohet.

**Blerjet minus shitjet e sendeve me vlerë.**

Kjo kategori duhet të analizohet në vlerësimet e bëra.

**Eksportet dhe importet e mallrave dhe shërbime.** Kjo kategori duhet të analizohet në vlerësimet e bëra.

**ANEKSI II**  
**PERIUDHA KALIMTARE**  
Periudhat kalimtare sipas Parimit Nr 3

<b>Vendi</b>	<b>DERI</b>
Irlanda	2004
Portugalia	—
Danimarka	2000 (në 1999 viti bazë do te jete 1990)
Finlanda	2005
Hollanda	—
Italia	2003
Germania	2005
Belgjika	—
Mbreteria Bashkuar	2003
Franca	—
Spanja	2003
Greqia	—
Suedia	—
Luksemburgu	—
Austria	2005